



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:231712

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05821576

C.nr.1020/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike të paditësit I (H) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Rasim Hoti nga Rahoveci, kundër të paditurit S (A) M, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 1000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 04.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësit I (H) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

II. VËRTETOHET se paditësi I (H) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.01040-0, Zona Kadastrale Ratkoc, pronë private, vendi i quajtur “Zalina”, me kulturë ”Tokë Bujqësore - Arë e klasës 4”, në sipërfaqe prej 3949 m², e cila kufizohet në anën veri – lindore me pikën zero, në anën jug – lindore me parcelën kadastrale nr.2465-1 në gjatësi prej 101.82m, me parcelën kadastrale nr. 1049-2 në gjatësi prej 18.50m dhe me parcelën nr.1049-1 në gjatësi prej 19.49m, në anën jug - perëndimore me parcelën nr.1042-0 në gjatësi prej 23.56m dhe me parcelën nr. 1041-0 në gjatësi prej 68.02m, si dhe në anën veri – perëndimore me parcelën nr.1025-0 në gjatësi prej 21.97m + 12.61m + 41.20m + 11.39m, në gjatësi të përgjithshme prej 87.17m.

III. DETYROHET i padituri S (A) M, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, që ta pranojnë këtë të drejtë dhe që të lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë 1040-0, ZK Ratkoc, në emër të paditësit në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit.

IV. Shpenzimet procedurale i bartë paditësi I.H.K

A r s y e t i m

Paditësi I (H) K nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit S (A) M, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të vërtetimit të

pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) në paluajtshmërinë - parcelën nr.1040-0, ZK Ratkoc.

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av. Rasim Hoti, në padi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Duke shtuar qysh para luftës paditësi e ka blerë parcelën kontestuese, që nga ajo kohë ka hyrë në posedim të paluajtshmërisë, çmimin e ka paguar në tërësi, mirëpo për shkak të rrethanave të atëhershme nuk kanë bërë marrëveshje formale, por vetëm marrëveshje gojore, e cila është respektuar në tërësi. Gjatë administrimit të provave është vërtetuar fakti se paditësi I (H) K është në posedim të pandërprerë të kësaj parcele kadastrale, e po ashtu edhe i padituri Skender Morina po e pohon se në këtë parcelë ia njuh të drejtën për të u bërë pronar juridik Isaj Krasniqi, pasi që i njëjti si pronar faktik është më shumë se 40 vite. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të ia njoh të drejtën për të u regjistruar në librat kadastral, në parcelën nr. 1040-0, në sipërfaqe prej 3949 m², ZK Ratkoc, siç është përshkruar edhe në ekspertizën. I njëjti ka deklaruar se shpenzimet e procedurës do ti bartë paditësi.

I padituri në përgjigjen në padi, seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbetemi pranë përgjigjes në padi, nuk e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Duke shtuar se është e vërtetë se paditësi e ka blerë parcelën kontestuese dhe është në posedim që nga viti 1980, të hollat sipas marrëveshjes i ka paguar menjëherë, të cilën e shfrytëzon pa kurrfarë pengese, si atëherë edhe tash. Gjykatës i ka kërkuar që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë si të bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezantuar palët ndërgjyqëse. Ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe se bashku me palët ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të bëjë identifikimin e parcelës, sipërfaqen, kufizimet e parcelës dhe kush është në shfrytëzim të saj.

Gjithashtu, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

1. Certifikatë e pronës, me numër të lëndës 08-942/03-0032591/21;
2. Ekspertizë e gjeodezisë, e ekspertit A.M, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 22.05.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke qenë se i padituri e kanë pohuar kërkesëpadinë, që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj.

Gjykata me administrimin e certifikatës së paluajtshmërisë 08-942/03-0032591/21, e datës 28.07.2021 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 20.05.2024 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela nr. nr.1040-0, Zona Kadastrale Ratkoc, me sipërfaqe prej 3949m² evidentohet në emër të të paditurit S (A) M, me pjese ideale 1/1.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadsisë nga i padituri, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësit me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thënieve në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga i padituri, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që paditëset janë të evidentuara si pronare të paluajtshmërive, që vërtetohet përmes certifikatës së pronës me nr. 08-942/03-0055898/22, e datës 27.12.2022 dhe certifikatës së pronës me nr. 08-942/03-0056211/22, e datës 28.12.2022.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadsisë nga ana e të paditurit konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadsinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)”*, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që paditësi ka deklaruar se do ti bartë shpenzimet e kësaj procedure, si dhe në kuptim të nenit 455 LPK-së, gjykata ka vendosur sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA E THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.1020/2021 më datë 04.06.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.